

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7146
E mërkurë, 20 mars 2024
Çmimi 0.50 €

Ndërron jetë ish-truproja
e Hashim Thaçit,
komandant "Raketa" | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI: PREJ QË JAM KRYEMINISTËR OPOZITA KËRKON ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME. NDOSHTA DO TË KETË!

FAQE 4-5



Kryeministri Albin Kurti ka thënë të martën se prej javës së dytë që kur ka marrë detyrën e kryeministrit është folur për zgjedhje të parakohshme, por ai sot është në

vitin e tretë të qeverisjes. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Kurti ka thënë se zgjedhje të parakohshme nuk mund të kemi në Kosovë pa opozitën, megjithatë

ka thënë se ato edhe mund të ndodhin. Kurti në këtë intervistë ka folur edhe për raportet me ShBA-në, çështjen e dinarit dhe dialogun me Serbinë në përgjithësi f

KËRKOHEM
QË KUVENDI
TA SHTOJË
DINAMIKËN E
MBIKËQYRJES
SË ZBATIMIT
TË LIGJEVE | F. 3



MINISTRA DHE
EURODEPUTETË
KËRKOJNË
PËRSHPEJTIMIN
E ZGJERIMIT
TË BE-së | F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

90 MILIONË EURO MBËSHETJE
PËR REFORMA NË KOSOVË
NGA BANKA BOTËRORE | F. 8

SPORT



KOSOVA ZHVILLON STËRVITJEN E
DYTË, SYNOHET PËRCATITJA E MIRË
PËR NDESHJET E SHTATORIT | F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Navalnaya i bën thirrje botës të mos e njohë Putinin si lider legjitim

MOSKË, 19 MARS - Yulia Navalnaya, e veja e politikanit opozitar rus Aleksei Navalny, i ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar ta refuzojë njohjen e presidentit Vladimir Putin si lider "legjitim" të shtetit, pas zgjedhjeve të fundjavës që "nuk kanë asnjë rëndësi".

Duke folur për mbështetësit e saj, përmes një video-mesazhi të publikuar në rrjetet sociale, më 19 mars, Navalnaya ka bërë thirrje të mos ketë dorëzim në të bërit opozitë ndaj Putinit, i cili lehtësisht i ka fituar më shumë se 87 për qind të votave në mungesë të rivalëve pasi ata janë burgosur, ose u është ndaluar gara. "Rezultatet e këtyre zgjedhjeve nuk kanë asnjë kuptim. Putini

dëshiron t'i tregojë botës se ka shumë mbështetje", ka thënë Navalnaya. "Këto zgjedhje janë kryer, por asgjë nuk është përfunduar. E kundërta, ne duhet ta mbledhim forcën dhe të punojmë më fort sesa më parë", ka shtuar ajo.

Putini e ka shpallur fitoren për mandatin e pestë presidencial pas zgjedhjeve të mbajtura më 15-17 mars, të cilat janë dënua prej Perëndimit, duke u cilësuar as të drejta, as të lira.

Besohet që përmes këtyre zgjedhjeve Putini ka tentuar të fitojë përkrahje për luftën e nisur në Ukrainë dhe politikën e tij gjithnjë e më shtypëse.

Putini, 71-vjeçar, i cili ka udhëhequr në Rusi, qoftë si



president, apo si kryeministër, prej vitit 2000 - pritet ta tejkalojë udhëheqësinë 30-vjeçare të Josef Stalinit, nëse do ta përfundojë këtë mandat të ri. Kështu, ai do të

mund të bëhet lideri rus që ka shërbyer më së gjati në dy shekujt e fundit.

Vëzhguesve të pavarur u është ndaluar pjesëmarrja në zgjedhje

për herë të parë në historinë post-sovjetike të Rusisë, kanë thënë ekspertët.

Në video Navalnaya i ka lavdëruar rusët që kanë marrë pjesë në protestën e 17 marsit, që është organizuar nga ndihmësit e Navalnyt në Rusi dhe vende të tjera. Ajo aktualisht është duke jetuar jashtë Rusisë, mirëpo është zotuar se do ta vazhdojë luftën e burrit të saj "për një Rusi të mrekullueshme në të ardhmen". Burri i saj, Aleksei, ka vdekur më 16 shkurt, në një prej burgjeve më famëkeqe të Rusisë, në rrethana të dyshimta.

Navalnaya dhe shumë qeveri perëndimore e fajësojnë Putinin për vdekjen e kritikut të Kremlinit.

Hong Kongu miraton ligjin e ri për siguri kombëtare

HONG KONG, 19 MARS - Hong Kongu e ka miratuar një ligj të ashpër të sigurisë kombëtare për të cilin autoritetet kanë thënë se është i domosdoshëm për stabilitet.

Megjithatë, sipas kritikëve, ky hap do t'i gërryjë edhe më tepër liritë civile.

Artikulli 23 shënjestron shkelje si ndërhyrja e jashtme dhe rebelimi, dhe ndëshkimet përfshijnë edhe dënime me vdekje.

Dokumenti ka kaluar shpejt në fazën finale nga parlamenti i qytetit, që është pro-Pekinit, në më pak se dy javë.

Artikulli 23 e zgjeron një ligj kontrovers për siguri kombëtare, që është miratuar më parë prej Kinës. Ai ligj tashmë i ka bërë

vepra penale shkaputjen e vendit, përmbysjen e pushtetit, terrorizmin dhe bashkëpunimin me forca të huaja në Hong Kong. Mirëpo lideri i Hong Kongut, John Lee, ka thënë se Artikulli 23 është i domosdoshëm për t'u ruajtur prej "sabotazhit të mundshëm dhe situatave të tjera që mund të shkaktojnë telashe", sidomos idetë për një "Hong Kong të pavarur".

Ai e ka konsideruar miratimin e ligjit si "moment historik për njerëzit e Hong Kongut që kanë pritur për më shumë se 26 vjet". Zëvendëskryeministri i Kinës, Ding Xuexiang, ka thënë se miratimi i ligjit do t'i mbronte "interesat kryesore kombëtare" dhe do t'i mundësonte Hong Kongut që të fokusohet në

zhvillim ekonomik.

Dhjetëra persona janë arrestuar pas miratimit të Ligjit për Siguri Kombëtare më 2020. Kritikët besojnë se ai ka krijuar një klimë frike në Hong Kong.

Drejtoresha e Agjencisë Ndërkombëtare Amnesty International për Kinën, Sarah Brooks, ka thënë se ligji i ri "përbën goditje të re për të drejtat e njeriut në qytet", derisa Maya Wang, ushtruese e detyrës së drejtoreshës për Kinën në organizatën tjetër

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Human Rights Watch, kanë thënë se ligji i ri do ta fusë Hong Kongun në "epokën e re të autoritarizmit".

Kur Mbretëria e Bashkuar ia ka dorëzuar Kinës Hong Kongun më



1997, qytetit i ishin garantuar disa liri për 50 vjet, sipas marrëveshjes së nënshkruar, të njohur me sistemin "një shtet, dy sisteme". Mirëpo Perëndimi beson se ligjet

e reja do të mund t'i rrezikojnë liritë në këtë rajon dhe do ta dëmtojnë statusin e Hong Kongut si qendër lidere biznesore.

Austin: ShBA-ja nuk do ta lërë Ukrainën të dështojë

WASHINGTON, 19 MARS - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha se Amerika do të vazhdojë ta mbështesë Ukrainën në luftën e saj kundër pushtimit të nisur nga Rusia, edhe pse paketa e ndihmës prej 60 miliardë dollarësh vazhdon të mbetet e bllokuar në Dhomën e Përfaqësuesve për shkak të kundërshtimit të republikanëve. "ShBA-ja nuk do ta lërë Ukrainën të dështojë", tha Austin para afër 50 aleatëve të Ukrainës, në nisje të takimit të Grupit të Kontaktit për Mbrojtje të Ukrainës në bazën ajrore amerikane Raimstein në Gjermani.

Takimi mujor i këtij grupi, që njihet edhe si Formati i Ramstein-it, është për të diskutuar për mënyrat se si të rritet mbështetja ushtarake për Kievin, teksa forcat



ukrainase po përballen me mungesë municionesh dhe armësh të rënda të avancuara, teksa ato po përballen me forcat

ruse që po përparojnë në frontin lindor. "Trupat ukrainase po përballen me kushte të rënda dhe luftime të ashpër. Civilët ukrainas

po përballen me breshëri të vazhdueshme të raketave ruse dhe dronëve iranianë. Por, Ukraina nuk do të ndalet. As ShBA-ja", tha Austin, i cili është në udhëtimin e parë jashtë vendit që kur ka nisur trajtimin për kancer në prostatë.

Ai, po ashtu, përsëriti se 315 000 trupa ruse janë vrarë apo plagosur që kur nisi lufta më 2022 dhe tha se pushtimi deri më tani i ka kushtuar Moskës 211 miliardë dollarë.

Përderisa paketa e ndihmës në vlerë prej 60 miliardë dollarësh vazhdon të jetë e bllokuar në Dhomën e Përfaqësuesve, ShBA-ja më 12 mars njoftoi për një paketë të ndihmës ushtarake për Ukrainën në vlerë prej 300 milionë dollarësh. Kjo shumë është marrë nga Pentagoni.

Ndihma ushtarake evropiane për Ukrainën është bërë kritike për trupat ukrainase që po përballen me superioritetin e armikut si në numër të ushtarëve, por edhe në numrin e municioneve të artillerisë që shpenzojnë në fushëbetje.

Një ditë më herët Këshilli Evropian miratoi krijimin e Fondit për Ndihmë të Ukrainës dhe dedikoi 5 miliardë euro për të. Me këtë fond, sipas BE-së, do të vazhdohet mbështetja e Ukrainës "për ta mbrojtur veten nga lufta e agresionit rus", duke premtuar se ndihma për Kievin do të zgjasë për aq kohë sa të ketë nevojë. Me këtë fond, BE-ja tha se do të blihen "pajisje vdekjeprurëse dhe jovdekjeprurëse ushtarake" dhe do të ofrohen trajnime.

Reagim i KMDLNj-së

ZRrE “kompenson” qytetarët përmes tarifave të reja në prill

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vërtetuar vendimet e gjykatave tjera duke kërkuar që ZRrE t'ua kompensojë qytetarëve të Kosovës shumën prej 40 milionë eurove që në mënyrë të kundërligjshme ua ka vjedhur në periudhën 2012 - 2017 për t'ua paguar rrymën qytetarëve të katër komunave në veri të Kosovës të cilët asnjëherë nuk e kanë paguar rrymën, që nga përfundimi i luftës, deri më sot. ZRrE e ka pranuar këtë vendim por se nuk është deklaruar për mënyrën e kompensimit. Fillimisht bëhej fjalë për 100 milionë të vjedhura e që me alkiminë e këtij rregullatori zhatës u zvogëluua në 40 milionë. Qeveria aktuale e Kosovës për këtë vendim e ka zgjedhur gjuhën e peshkut - të heshtjes ndonjëse nuk ka lënë pa kritikuar vendimet tjera. KMDLNj ka propozuar që kompensimi të bëhet për tre muaj, të bëhet me para të gatshme duke përfshirë



kamatat e rregullta bankare dhe ato ndëshkuese, shkallën e inflacionit dhe ngritjen e çmimeve. Ky kompensim do të mbikëqyrjet nga një Komision parlamentar i udhëhequr nga opozita e tashme. Mënyrat tjera të kompensimit përmes faturave në të ardhmen

është legjitimim i vjedhjes sikur edhe krijim i mundësive tjera për vjedhje. Ministria shpërdoruese e ndërlidhur me ZRrE-në Artane Rizvanolli deklaroi se këtë vit nuk do të ketë ngritje të çmimit të energjisë elektrike edhe ashtu më e shtrenjta në rajon dhe e përafërt me

çmimet në vendet e BE - së. Menjëherë pas kësaj deklarate, ZRrE doli me informatë se në mars apo prill të këtij viti do të ketë shqyrtim të tarifave të energjisë elektrike. ZRrE po e bënë punën që më së miri dinë ta bëjë, rrjepjen e lëkurës së konsumatorëve përmes vjedhjes duke fryrë dhe ngritur çmimin e rrymës dhe duke diskriminuar qytetarët në baza etnike. KMDLNj- e ka kërkuar nga Prokuroria e Shtetit të hetojë ZRrE - në për faktin se të gjitha nivelet gjyqësore kanë vërtetuar se qytetarët janë dëmtuar - vjedhur nga ky Rregullator i kriminalizuar për së paku 40 milionë euro. Pas hetimeve, KMDLNj mendon se kjo shifër do të dali shumë më e lartë. Me një qeveri që është aleate e ZRrE, me një Prokurori jovepruese, me një opozitë të raskapitur fare dhe e ngarkuar me mëkate nga e kaluara për çështjen e vjedhjes përmes faturave të fryra, qytetarët e

Kosovës jo që nuk do të zhdëmtohen për dëmet që u janë bërë dhe po ua bënë ky Rregullator i kriminalizuar dhe i veshur me përkrahje politike por këtë keqbërje do ta vazhdojë edhe në të ardhmen. Për KMDLNj është i pakuptueshëm dhe i papranueshëm mosreagimi i qytetarëve, si gjatë faturave me çmime shumë të larta dhe të papërbalueshme muajve të fundit, ashtu edhe me lojën e pingpongut për kompensim si dhe paralajmërim për shtrenjtim të radhës. Qytetarët e Kosovës, në vend se të marrin kredi me kamata shumë të larta për t'i paguar faturat e rrymës, më efektive dhe më pak e kushtueshme do të ishte të protestojnë në numër të madh para ZRrE dhe qeverisë në mënyrë që t'i realizojnë të drejtat e tyre që brutalisht po iu shkelen. Derisa qytetarët të heshtin, loja e pistë e ZRrE do të vazhdojë!

Kërkohet që Kuvendi ta shtojë dinamikën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka takuar kryetarët e komisioneve parlamentare për të diskutuar për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Pjesë e këtij takimi ishin edhe përfaqësuesit e NDI-së, e cila, së bashku me USAID-in, e kanë mbështetur Kuvendin për hartimin e doracakut për procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kryetari Konjufca tha se, përveç miratimit të ligjeve, edhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre është shumë e rëndësishme për shoqërinë dhe shtetin e Kosovës.

Kryetari i Kuvendit i inkurajoi kryetarët e komisioneve parlamentare që të hartojnë edhe miratojnë projektligje sa më përmbajtjesore, njëkohësisht të fokusohen edhe në aktivitetet mbikëqyrëse të Kuvendit.

Kryetari Konjufca, po ashtu, kërkoi nga kryetarët e komisioneve



parlamentare që raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve t'i publikojnë me kohë.

Kreu i Kuvendit falënderoi USAID-in dhe NDI-në për mbështetjen e vazhdueshme, duke vlerësuar se doracaku për procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve do ta plotësojë boshllëkun sa i përket

metodologjisë së procesit mbikëqyrës që ka ekzistuar në Kuvendin e Kosovës.

Përfaqësuesi i NDI-së, Valon Kurhasani, tha se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është sfidë jo vetëm për Kuvendin, por edhe për kuvendet e shteteve të tjera. Kurhasani theksoi se gjatë hartimit

të doracakut janë marrë praktikat e disa vendeve evropiane dhe se pas një periudhe kohore të pilotimit, së bashku me Kuvendin do të vlerësohet nëse është e nevojshme që të plotësohet apo jo.

Gjatë diskutimit, kryetarët e komisioneve parlamentare folën për përvojat dhe sfidat e procesit të

mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve në Kosovë.

Doracaku i hartuar me mbështetjen USAID-it dhe NDI-së u vlerësua lart edhe nga kryetarët e komisioneve parlamentare. Ishte konkluzion i përbashkët që Kuvendi duhet ta shtojë dinamikën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve në Kosovë.

Kurti mori pjesë në hapjen e ekspozitës “Njëzet e pesë vjet të Republikës së Çekisë në NATO”

PRISHTINË, 19 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në hapjen e ekspozitës të titulluar “Njëzet e pesë vjet të Republikës së Çekisë në NATO”, që u mbajt në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani” në Prishtinë, për ta shënuar kështu 25-vjetorin e anëtarësimit të Republikës së Çekisë në NATO.

Organizuar nga Ambasada e Republikës së Çekisë në Kosovë, në hapjen e ekspozitës ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve dhe të korit diplomatik në vend. Me synim të qartë dhe përkushtim të parëzervë për rrugën euroatlantike, kryeministri Kurti e uroi ambasadorin çek në Kosovë, Bohumil Mazanek, me rastin

e këtij përvjetori të rëndësishëm, dhe e falënderoi atë dhe shtetin e Çekisë për rolin dhe kontributin në rrafshin e sigurisë.

Republika e Çekisë së bashku me Poloninë dhe Hungarinë, tri shtete të ish-Bllokut Lindor, u bënë anëtare të NATO-s më 12 mars të vitit 1999.





Kurti: Prej që jam kryeministër opozita kërkon zgjedhje të parakohshme. Ndoshta do të ketë!

Kryeministri Albin Kurti ka thënë të martën se prej javës së dytë që kur ka marrë detyrën e kryeministrit është folur për zgjedhje të parakohshme, por ai sot është në vitin e tretë të qeverisjes. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Kurti ka thënë se zgjedhje të parakohshme nuk mund të kemi në Kosovë pa opozitën, megjithatë ka thënë se ato edhe mund të ndodhin. Kurti në këtë intervistë ka folur edhe për raportet me ShBA-në, çështjen e dinarit dhe dialogun me Serbinë në përgjithësi

PRISHTINË, 19 MARS - Kryeministri Albin Kurti, në një intervistë dhënë "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se mund të ketë edhe zgjedhje të parakohshme. Ai ka thënë se që prej javës së dytë kur e ka marrë detyrën e kryeministrit është folur për zgjedhje të parakohshme, por ai sot është në vitin e tretë të qeverisjes. "Prej javës së dytë që jam kryeministër është folur për zgjedhje të parakohshme. Unë këtë javë i bëj tri vjet që jam në detyrë. Ndoshta do të ketë zgjedhje të parakohshme!", ka thënë Kurti për REL.

I pyetur se a duhet të ketë zgjedhje të parakohshme ende pa përfunduar mandatin, Kurti është përgjigjur: "Për ne është krejt njësoj, por unë zgjedhje të parakohshme nuk mund të kem në Kosovë pa opozitën. Nëse opozita do zgjedhje të parakohshme duhet të shpërndahet Kuvendi. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nga viti 2020 nuk ka lënë mundësi të

tjera. Pra ne, për të pasur zgjedhje të parakohshme, duhet ta shpërndajmë Kuvendin dhe le të mbahen zgjedhjet e parakohshme për ata të cilët i kanë mendtë aty. Unë nuk kam problem për asnjërin variant, mirëpo shumë gjëra mund t'i bëjmë pa opozitën, por jo edhe këtë".

Nuk ka propozime që pranohen e që janë në kundërshtim me rregulloren e BQK-së

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, thotë se nuk do të pranojë propozime lidhur me dinarin e që janë në kundërshtim me rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës. Ai tha se rregullorja e re "nuk është ndëshkim, por është një përpjekje e radhës shumë serioze për të bërë formalizimin, legalizimin e

transaksioneve financiare". Sa i takon çështjes së dialogut politik me Serbinë, ai thotë se ky proces ka ngecur te shkeljet që ia bën Serbia marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve. "Nuk mund të kemi zbatim të marrëveshjes pa respektim të saj", tha Kurti. Duke folur për çështjen e tokave rreth Manastirit të Deçanit, ai thotë se ka përfunduar gjithçka dhe, sipas tij, Kosova e ka rastin unik që në pranverë të anëtarësohet në Këshillin e Evropës.

Marrë përgjegjësinë për pasojat që mund të shkaktohen në terren nga dinari

"Por, unë gjithashtu e marr përgjegjësinë që pasojat e caktuara, të cilat mund të shkaktohen në terren, mund të jenë çështje e

qeverisë - jo vendimi si i tillë, i cili është sovran i Bankës Qendrore të Kosovës, por edhe një herë ne vetëm bëjmë zbatimin e ligjit dhe Kushtetutës në terren - nëse ka pasoja të caktuara që u referohen ministrave tanë për çështjen e dinarit", ka thënë Kurti.

Në pyetjen se presidentja ka thënë se ka një lloj pajtimi për dinarin serb, Kurti ka theksuar se ka pasur vazhdimisht opsione të ndryshme për çështjen e dinarit. "Unë nuk besoj që duhet të diskutohen tash, sepse dëmtohet pozicioni negociator i Kosovës nëse ato shpalesen para kohe. Ajo çfarë mund të them është se qeveria po e bën më të mirën e mundshme, me përkushtim maksimal dhe natyrisht që këtë ne e kemi si mbështetje për rregulloren e re të Bankës Qendrore të Kosovës. Nuk ka kurrfarë ndëshkimi për serbët. Pra, rregullorja e re nuk është ndëshkim, por është një përpjekje e radhës shumë serioze për ta bërë formalizimin, legalizimin e transaksioneve financiare. Ju e dini që ne kemi ndarë një buxhet për shqiptarët në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Ne e dërgojmë atje ndihmën financiare në euro, ndërkaj në banka atje merret në dinarë. Ngjashëm do të mund të

ishite edhe këtu. Pra, ajo dërgesa që vjen në dinarë do të mund të merrej në euro", është shprehur Kurti. "Ata japin vazhdimisht propozime. Unë nuk është e thënë që propozimet e tyre t'i shpales publikisht duke bërë zëdhënësin e ambasadave. Nuk e bëj dot këtë punë. Unë po tregoj që ne i kemi ofruar një letër Bankës Popullore të Serbisë nga ana e guvernatorit, që në këtë rast na përfaqëson të gjithëve si qytetarë të Republikës, juve si gazetarë, mua si kryeministër, dhe ne presim përgjigje nga ana tjetër", është përgjigjur Kurti kur është pyetur se janë diskutuar disa çështje me faktorin ndërkombëtar.

Dialogu ka ngecur te shkeljet që ia bën Serbia marrëveshjes

Duke folur për dialogun me Serbinë, Kurti ka thënë se ky proces ka ngecur. "Ka ngecur te shkeljet që ia bën Serbia marrëveshjes. Së paku tetë nga 11 nenet e Marrëveshjes Bazike, Serbia i ka shkelur. Dhe, kjo ka kulmuar me letrën e ish-kryeministres Ana Bernabiq, e cila tash do të jetë kryetare e Parlamentit të Serbisë, ku ajo thotë se praktikisht tërhiqen nga

Ministra dhe eurodeputetë kërkojnë përsheptimin e zgjerimit të BE-së

PRISHTINË, 19 MARS - Deputetët e Parlamentit Evropian në Komisionin për Politikë të Jashtme, dhe një varg ministrash të Jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, kanë mbështetur procesin e zgjerimit të BE-së dhe kanë tërhequr vërejtjen se procesi duhet të përsheptohet pasi, sipas tyre, deri tash ka qenë tepër i ngadalshëm. Ata kanë thënë se dinamika e procesit të zgjerimit duhet të përsheptohet edhe si përgjigje ndaj sfidave të reja gjeopolitike pas agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës.

Deklaratat e tyre u bënë në një debat të përbashkët në Komisionin për Politikë të Jashtme të PE-së, me disa ministra të Jashtëm të vendeve anëtare, që u zhvillua të martën në Bruksel, raporton REL.

Kjo ishte hera e parë që një debat i

tillë u zhvillua me praninë e eurodeputetëve dhe të ministrave të BE-së. Debatu u organizua vetëm dy ditë para se shefat e shteteve apo qeverive të BE-së të diskutojnë në Bruksel për nisjen e negociatave për anëtarësimin e Bosnjë-Hercegovinës dhe për disa vendime të tjera lidhur me zgjerimin.

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, David McAllister, tha se zgjerimi i BE-së do të jetë temë edhe gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet evropiane dhe kërkoi nga Komisioni Evropian të dalë me propozimin e reformave që BE-ja duhet t'i bëjë për t'u përgatitur për zgjerim.

Në debat, disa ministra, sidomos ata nga vendet baltike, kritikuan BE-në për ngadalësimin e procesit

të zgjerimit dhe për lëvizje të afateve kohore. Ata përmendën pritjet që Ukraina t'i niste negociatat e anëtarësimit të saj në mars apo prill, teksa tash një gjë e tillë nuk pritet së paku deri në qershor.

Ministri i Jashtëm i Letonisë, Kristijanis Karins, ka thënë se Evropa nuk mund të lejojë që në kontinent të ketë zona gri sepse, sipas tij, ato zona do të tentojë t'i zaptojë Rusia. Ai bëri thirrje që së paku në qershor të nisin negociatat e anëtarësimit me Ukrainën dhe me Moldavinë. Karins shprehu shpresën që edhe Bosnjë-Hercegovina të kualifikohet për t'i nisur negociatat, ndërsa që vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor të lëvizin në procesin e negociatave të anëtarësimit.

Ministri i Jashtëm i Estonisë,

Margus Tsahkna, tha se sikur të mos ishte zgjerimi i BE-së dhe zgjerimi i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) para njëzet vjetësh, vendi i tij sot nuk do të ishte vend i pavarur.

Anëtarësimi në BE dhe në NATO, tha ai, është dëshmuar të jetë çështje e ekzistencës së shtetit. Ai e vlerësoi zgjerimin si proces të ndërtimit të arkitekturës së sigurisë në Evropë ku, siç deklaroi, më nuk ka hapësira për neutralitet e as për zona gri.

Ministria e Jashtme e Sllovenisë, Tanja Fajon, e cila në dy mandate ka qenë edhe deputete e Parlamentit Evropian, ka rikujtuar se ka pasur shumë vonesa në procesin e afrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke përmendur pritjet e gjata për nisjen e negociatave të anëtarësimit me

Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut si dhe heqjen e vizave për Kosovën. Ajo mbështeti idenë që viti 2030 të jetë vit kur BE-ja dhe vendet anëtare duhet të jenë gati për zgjerim. Fajon tha se vendet e Ballkanit Perëndimor dhe tri vendet lindore që tani janë kandidatë mund të avancojnë paralelisht.

Edhe ministrat nga Danimarka dhe Austria thanë se Evropa ka ndryshuar dhe se zgjerimi tash është i domosdoshëm, por ata përsëritën se procesi duhet të mbetet i bazuar në meritat individuale të vendeve kandidatë, që t'i përmbushin kriteret përmes reformave.

Ministri për Çështje Evropiane i Finlandës, Anders Adlercreutz, apeloj që përshtatja me politikën e jashtme të BE-së të jetë kusht në procesin e zgjerimit. Ai, po ashtu, tha se siguria dhe stabiliteti i Ballkanit Perëndimor është e rëndësishme jo vetëm për këtë rajon, por për mbarë Evropën.

Sekretari hungarez i Shtetit, Peter Sztaray, tha se në pjesën e dytë të vitit, kur Hungaria do ta ketë kryesimin e radhës të BE-së, zgjerimi do të jetë prioritet. "Do të donim që gjatë vitit 2024 të hapim kapituj negociues me Serbinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, të mbyllim kapituj me Malin e Zi dhe t'i nisim negociatat edhe me Bosnjë-Hercegovinën", u shpreh ai.

Deputetë të Parlamentit Evropian, në fjalimet e tyre, kërkuan që vendet e BE-së të jenë më korrekte në vendimet e tyre dhe të mos bllokojnë vendet kandidatë kur ato t'i përmbushin kriteret në procesin e zgjerimit. Në këtë debat, megjithatë, nga vendet anëtare ishin pak a shumë ata ministra që kishin mendim më pozitiv për zgjerimin. Në debat u pa mungesa e ministrave nga tri vendet më të mëdha anëtare, Gjermania, Franca dhe Italia.



Marrëveshja Bazike dhe nga aneksi i zbatimit [i arritur] në Ohër. Marrëveshja Bazike është së paku njohje reciproke, de facto. Ndoshta edhe më shumë, por së paku njohje de facto është. Dhe, ata u tërhoqën sepse thanë 'kurrë s'do ta pranojmë pavarësinë e Kosovës, kurrë s'do ta pranojmë integritetin territorial të Kosovës dhe as ulësen për Kosovën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara'. Ata, praktikisht, u tërhoqën nga marrëveshja pasi që gjatë gjithë vitit e kishin shkelur atë. Problemi që unë kam me ndërmjetësit evropianë dhe amerikanë është se e kanë toleruar shkeljen e marrëveshjes, mosrespektimin e marrëveshjes në vazhdimësi që e ka bërë Beogradi përgjatë muajve, javëve e madje edhe ditëve të vitit 2023, e të cilat kulmuan më 13 dhjetor, në Samitin e Këshillit Evropian, ku zonja [kryeministria e Serbisë, Ana] Bërnabiq tha që ne po tërhiqemi nga kjo marrëveshje. Pra, nuk

mund të kemi zbatim të marrëveshjes pa respektim të saj. Brukseli dhe Uashingtoni vazhdimisht kanë insistuar në zbatim të marrëveshjes, por si të zbatohet një marrëveshje që nuk respektohet?! Ata e shkelin çdo ditë marrëveshjen. Dhe dy ngjarjet kryesore që i kemi pasur vitin e kaluar është 24 prilli, kur Kosova e kaloi fazën e parë drejt anëtarësimit në Këshill të Evropës, e presidenti i Serbisë, Vuçiq, e mbajti një konferencë në të cilën tha se veriu i Kosovës është i okupuar, nuk e pranon marrëveshjen e kështu me radhë, deri te refuzimi të cilin e bëri Bërnabiq në mes të dhjetorit. Ndërkaq, në terren kemi pasur sulmet paramilitare ndaj personelit të sigurisë, në maj, ku mbi 90 ushtarë të KFOR-it, por edhe policë dhe gazetarë, u lënduan rëndë e lehtë, dhe vrasja e rreshterit të Kosovës, heroit tonë Afrim Bunjaku, më 24 shtator. Më 27 shkurt i bëmë marrëveshjet, më 18

është aneksi i zbatimit. Shihni se çfarë ndodh më vonë", ka theksuar kryeministri Kurti.

Kurti ka folur edhe në lidhje me çështjen e Manastirit të Deçanit. Ai ka theksuar se janë njoftuar që nga tri parakushte që thuhej se do të mund të ishin, në fakt ekzistonte vetëm një. "Ne jemi njoftuar që nga tri parakushte që thuhej se do të mund të ishin, në fakt ekziston vetëm një. Dhe kjo ka ndodhur pas një vizite që kanë pasur kryeparlamentari [Glauk] Konjufca me zëvendësministrin e Jashtëm [Kreshnik] Ahmeti dhe takimeve dhe komunikimeve që i ka zhvilluar zëvendëskryeministria Donika Gërvalla. Pra, vetëm një parakusht. Por, kjo përputhet edhe me raportin e juristëve eminentë. Kjo ka qenë që të zbatohet aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për ata 24 hektarë, që janë në kuadër të zonës së veçantë të Manastiri i Deçanit. Ka pasur tendencë që të ketë edhe parakushte të tjera, por ka vetëm

një parakusht. Nga pikëpamja jonë, kjo çështje është mbyllur. Në këtë javë do të duhej që raportuesja Dora Bakoyanis ta dorëzojë raportin e saj në Komitet, të kalojë në Komitet, në mes të muajit prill të kalojmë edhe tek Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. Ndërkaq, në fund të muajit maj, edhe të bëhemi anëtar me të drejta të plota. Dhe unë mendoj se është moment i jashtëzakonshëm historik dhe gjeopolitik. Federata Ruse jashtë, Republika e Kosovës anëtarësohet", ka deklaruar Kurti.

Nuk kam kohë të mendoj edhe për opozitën

Në pyetjen se po të ishit sot në opozitë dhe të kishte një qeveri tjetër që do të merrte vendime të tilla, si do të reagonit, me protesta...? "Nuk kam kohë të mendoj edhe për opozitën. Për opozitën le të mendojë opozita.

Unë po mendoj si kryeministër, sepse për më shumë se dy dekada kam menduar si opozitar. Besoj se gjithë energjinë, kohën dhe nervat që i kam pasur për të menduar si opozitar, i kam shterur", ka thënë Kurti, duke shtuar se vazhdimisht e kupton opozitën. "Sepse i dëgjoj se çfarë thonë, i marrë me seriozitet dhe me sinqeritet, mirëpo duhet pranuar se, në kuptimin e polemikave, unë jam kryeministri që më së paku është ballafaquar me opozitën prej se Kosova ka kryeministër", është shprehur ai. Duke folur për raportet me miqtë ndërkombëtarë, kryeministri ka thënë se miqtë janë miq pavarësisht prej mospajtimeve, jo për shkak të pajtimeve. "Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, janë jo vetëm aleatë dhe partnerë, por edhe miq të pazëvendësueshëm për ne. Por, kjo nuk do të thotë se ne do të kemi mendime identike çdoherë, kudo, për gjithçka", ka thënë Kurti.

"Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të internetit", policia ligjëron në shkollat e Prizrenit

PRIZREN, 19 MARS - Drejtorja Rajonale e Policisë në Prizren, njësitet e sektorit dhe ai i komunitetit të Stacionit të Policisë në Prizren, në zbatim të Strategjisë të Policisë të Udhëhequr nga Inteligjenca dhe Policimi në Bashkësi, e bazuar në aktivitetet e parapara nga projekti "Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të

internetit" të hartuar nga Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Parandalim - DPP/Prishtinë, ka realizuar aktivitetet e planifikuara, gjegjësisht mbajtjen e ligjëratave në shtatë shkolla të komunës së Prizrenit dedikuar nxënësve të klasave të pesta deri të klasat e nënta. Temë e ligjërimit ishte "Masat e sigurisë ndaj

keqpërdorimit të internetit". Kjo temë ka zgjuar interesim të nxënësve, duke qenë bashkëbisedues, po ashtu duke parashtruar edhe pyetje në lidhje me masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të internetit. Policia ka njoftuar se me ligjëratat të tilla do të vazhdohet edhe me tutje në shkollat e tjera në rajonin e Prizrenit.



Totaj pret në takim ambasadorin amerikan, flasin për zhvillimin e komunës së Prizrenit

PRIZREN, 19 MARS - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Jeff Hovenier, me të cilin ka diskutuar për zhvillimin e komunës së Prizrenit, projektet e infrastrukturës, përpjekjet për gjallërimin ekonomik dhe masat për ta promovuar zhvillimin e qëndrueshëm

urban dhe rural. Gjithashtu, biseduan për trashëgiminë e pasur kulturore të Prizrenit dhe potencialit turistik, duke vënë theksin te festivalet e shumta, koncertet dhe aktivitetet artistike që synojnë ta shfaqin pasurinë kulturore gjatë gjithë vitit, për audiencën vendore dhe atë ndërkombëtare.



Skenderaj, nis projekti i trajtimit të ujërave të zeza në Rakinicë

Skenderaj, 19 mars - Komuna e Skenderajt ka nisur realizimin e projektit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Rakinicë. Kryetari i komunës, Fadil Nura, ka përcjellë nga afër fillimin e këtyre punimeve.

"Në Rakinicë, për të filluar projektin e trajtimit të ujërave të zeza, në gjatësinë e mbi 2,500 metrave duke përfshirë lagjet e patrajtuara në sistemin e ri, një premtim i përmbushur!", ka shkruar Nura në "Facebook".

Shpërndahen 411 pako ushqimore për familjet me gjendje të rëndë ekonomike në Podujevë

PODUJEVË, 19 MARS - Gjatë këtyre ditëve është bërë shpërndarja e 411 pakove ushqimore, 300 janë donacion nga organizata "Qatar Charity" dhe 111 nga familja Blakqori (në emër të familjarit tashmë të ndjerë, Nexhat Blakqori) këto pako janë ndarë për familjet me gjendje të rëndë ekonomike në komunën e Podujevës. Përzgjedhja e familjeve për përfituesit e pakove ushqimore

është bërë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bazë të regjistrave që ka kjo drejtori për familjet me gjendje të rëndë ekonomike. Komuna e Podujevës ka falënderuar të gjithë donatorët për bashkëpunimin me institucionet për t'u dalë në ndihmë familjeve në nevojë gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit.



Totaj takon përfaqësuesit e OVL të UÇK-së Dega në Has, diskuton për nevojat dhe sfidat e tyre

Prizren, 19 mars - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim përfaqësuesit e OVL të UÇK-së Dega në Has. Totaj

ka bërë me dije se me përfaqësuesit e OVL të UÇK-së Dega në Has ka diskutuar për nevojat dhe sfidat e tyre si dhe për

gjetjen e mënyrave të bashkëpunimit në projekte të përbashkëta me komunën e Prizrenit.

Ndërron jetë ish-truproja e Hashim Thaçit, komandant "Raketa"

PRISHTINË, 19 MARS - Ka ndërruar jetë të martën ish-truproja e Hashim Thaçit, Xhavit Ferizi - komandant "Raketa". Kumbin për vdekjen e tij e ka dhënë i biri i tij, Azizi. "Lajm mortor! Me pikëllim të thellë e zemër të thyer, të dashur familjar, miq e dashamirë, ju njoftojmë se sot në mëngjes me datën 19 mars 2024 ka ndërruar jetë babai jonë Xhavit Ferizi - Raketa, duke na lënë përjetësisht të pikëlluar por krenar qe jemi gruaja dhe fëmijët

e tij! Zemra e tij pushoj e qetë dhe pranë me të dashurve të tij! Në këto momente vetëm krenaria për të është me e madhe se dhimbja! Për orën e saktë të varrimit ju njoftojmë me kohë!", ka njoftuar familja. Për vdekjen e tij kanë reaguar përfaqësues të PDK-së, bashkëlufetarë të tij, zyrtarë komunalë të Skenderajt dhe qytetarë të shumtë. Endrit Thaçi, djali i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka

reaguar për vdekjen e ish-truprojës së babait të tij, Xhavit Ferizi (Raketa). Ai në një story në "Instagram" ka postuar një fotografi të ish-presidentit Thaçi me "Raketën". "Ishte i pandashëm me babin plot 30 vjet. Ishte një prej njerëzve më të dashur të familjes. Do të jetosh përjetësisht në kujtimet tona, Raketë! Prehu në paqe", ka shkruar Endrit Thaçi. Raketa ka qenë edhe pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Rama: Do të negociohet që shteti të jetë pjesë e investimit të Kushnerit në Sazan

TIRANË, 19 MARS - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, tha se do të negociohet pjesëmarrja e shtetit në investimin e planifikuar të Jared Kushnerit në ishullin e Sazanit. Pas një takimi në Partinë Socialiste, Rama e cilësoi si një "ofertë fantastike me potencial të jashtëzakonshëm" projektin e dhëndrit të ish-presidentit amerikan Donald Trump. "Sot ne diskutojmë për një Shqipëri, e cila, përmes këtyre zhvillimeve, bëhet konkurrese e drejtpërdrejtë e atyre që janë luanët e Mesdheut që i kemi rreth e rrotull, që nga Kroacia, e Mali i Zi deri te Greqia poshtë... Aplikimin do ta shqyrtojmë në një proces sipas ligjit dhe mbi të cilin ne do ta negociojmë pjesëmarrjen e shtetit në atë investim", tha Rama, shkruan REL.

Dhëndri i ish-presidentit Trump konfirmoi javën që shkoi se ishte afër finalizimit të disa marrëveshjeve të mëdha për pasuri të paluajtshme në Shqipëri dhe në Serbi.

Kompania e Kushnerit, Affinity Partners, është në bisedime me dy vendet ballkanike për investime në prona turistike në vlerë mbi 1 miliard dollarë.

Kushner tha se firma e tij me bazë në Majami synon ta shndërrojë ishullin më të madh të Shqipërisë, Sazan, në Detin Mesdhe, në një destinacion luksoz për turistët.

Në Shqipëri, ai, gjithashtu, synon t'i ndërtojë disa hotele dhe qindra vila në Zvërnec, një zonë bregdetare në Vlorë, në jug të Shqipërisë.



Pas takimit me drejtuesit politikë të socialistëve në 12 qarqet e vendit, Rama tha se investimet në ishullin e Sazanit janë ide të kamotshme. "Transformimi i Sazanit në kurorën e artë të

turizmit mesdhetar është ambicie e kahershme. Për hir së vërtetës e kanë pasur dhe qeveritë dhe paraardhësit e mi. Nuk është bërë ende realitet. Më parë ka qenë e paimagjinueshme të afroheshin

investitorë në Shqipëri. Nuk bëhet fjalë për të falur asgjë që është e shqiptarëve. Përkundrazi, realizimi i këtyre investimeve pasuron shqiptarët", tha kryeministri shqiptar.

I pyetur se përse nuk u shpall tender ndërkombëtar, por u zgjodh një person me lidhje politike, Rama tha se qeveria e drejtuar prej tij "nuk zgjedh persona, por në bazë të legjislacionit shqiptar u referohemi ofertave dhe propozimeve që na bëhen".

Rama, megjithatë, tha se propozimi është në fazën e shqyrtimit dhe do të shihet nëse është në përputhje me vizionin e qeverisë si dhe me krijimin e një balance të domosdoshme mes zhvillimit dhe mbrojtjes së natyrës. Për pyetjen se kur ka lindur ideja e këtij projekti, referuar faktit se Kushner e ka vizituar dy herë jugun e Shqipërisë, Rama tha se kjo ide daton para se ai të bëhej kryeministër.

Pak javë më parë në Shqipëri u miratuan ndryshimet në Ligjin për Zonat e Mbrojtura, ndryshime që u hapin rrugë ndërtimeve në to të hoteleve apo projekteve të tjera që konsiderohen me rëndësi strategjike.

Ndryshimet u miratuan në seancën e 22 shkurtit në Kuvend, me vetëm votat e shumicës, ndërsa presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, i dekretoi ato më 18 mars.

Opozita në Shqipëri e ka akuzuar qeverinë Rama për mungesë transparence në lidhje me projektin e Kushnerit, ndërsa Ligjin për Zonat e Mbrojtura ka deklaruar se do ta dërgojë në Gjykatë Kushtetuese. Edhe ekspertët e mjedisit kanë shprehur rezerva për ligjin dhe investimet në zonat e mbrojtura.

Gjeneralët e FSK-së takuan shefin e shtabit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë

PRISHTINË, 19 MARS - Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Enver Cikaqi dhe drejtori i Drejtorisë së Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, qëndruan dje për vizitë në FARSh. Ata u takuan me shefin e shtabit të atjeshëm, gjeneralmajor Arben Kingjin dhe diskutuan për çështje të sigurisë që janë në interes të përbashkët për të dyja palët. Me këtë rast

gjeneral Cikaqi dhe gjeneral Hazrolli, si të ftuar nderi për pjesëmarrësit e programit të "Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes" (KLSM-14), ligjëruan për temat "Mjedisi i sigurisë në Kosovë - rast studimor" dhe "Institucionalizimi i bashkëpunimit në siguri - rasti i Kosovës".

Gjatë vizitës, gjeneralmajor Cikaqi dhe gjeneralmajor Hazrolli u pritën në takim të veçantë nga komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe

Sigurisë, gjeneralbrigade Ylli Pulaj, si dhe takuan nga afër kolonelin Avni Kiçina që është pjesë e KLSM-14 si dhe oficerët nga Forca e Sigurisë së Kosovës që janë duke u shkolluar në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është duke u zhvilluar me qëllim të ngritjes profesionale dhe ndërveprueshmërisë në mes të dy ushtrive.



90 milionë euro mbështetje për reforma në Kosovë nga Banka Botërore

PRISHTINË, 19 MARS - Bordi i Bankës Botërore ka miratuar marrëveshjen për Financimin e Politikave Zhvillimore për Politikën Fiskale, Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Gjelbër ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, me një vlerë prej 90 milionë eurosh. Kjo marrëveshje vjen si rezultat i veprimeve të realizuara të Republikës së Kosovës në

forcimin e stabilitetit fiskal dhe makroekonomik, rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike, krijimin e një ambienti të favorshëm për investime dhe fillimin e tranzicionit drejt një ekonomie të gjelbër.

Përmes marrëveshjes së re, e cila do të nënshkruhet muajin që vjen gjatë Takimeve Pranverore në Uashington DC, janë realizuar një varg veprimesh siç janë reforma

ligjore në fushën e edukimit në fëmijërinë e hershme, përmirësimi i efikasitetit të energjisë, zvogëlimi i barrës administrative, rritja e investimeve të huaja direkte, digjitalizimi dhe lehtësimi i të bërit tregti.

Vendimi i Bankës Botërore për ta mbështetur Republikën e Kosovës tregon përkushtimin e Bankës për t'i mbështetur politikatat zhvillimore në Kosovë.



BQK-ja nënshkruan marrëveshje me Fakultetin Ekonomik për avancim të bashkëpunimit dhe aktiviteteve në fushën e ekonomisë

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 MARS - Banka Qendrore e Kosovës, në kuadër të aktiviteteve të Javës Ndërkombëtare të Parasë, ka nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për ta avancuar bashkëpunimin dhe mbështetur aspektin akademik, avancimin e njohurive ekonomike dhe financiare, shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin për projekte të përbashkëta në fushën e ekonomisë, financave dhe edukimit financiar.

Gubernuratori i BQK-së, Ahmet Ismaili, ka potencuar se ky memorandum pritet të kontribuojë në zhvillimin dhe promovimin e njohurive në fushën e ekonomisë e financave në përgjithësi dhe edukimit financiar në veçanti.

Nisma të tilla do të konkretizohen edhe me bartësit e tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, meqë BQK-ja mbetet e përkushtuar për të kontribuar në këtë fushë të ndikimit, në pajtim me planin strategjik të saj.

Përmes ligjëratave në fushën e ekonomisë, banka dhe financa, si dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta, kjo nismë ka për qëllim kontributin në shkurtimin e zbrazëtisë midis kërkesave të tregut të punës dhe edukimit.

Veprimet e përbashkëta do të kontribuojnë në avancimin e dijes dhe zhvillimin e sektorit ekonomik në përputhje me objektivat e të dyja institucioneve. "Aktivitetet e përcaktuara në këtë



memorandum do të ndihmojnë në avancimin e bashkëpunimit midis BQK-së dhe Fakultetit Ekonomik, duke kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e njohurive në fushën e ekonomisë dhe financave. Zhvillimet në sektorin financiar janë thelbësore për zhvillimin ekonomik të një vendi. Sektorin financiar është pjesë integrale e strukturës ekonomike dhe ka një ndikim të madh në shumë aspekte të ekonomisë së një

vendi", ka theksuar guvernatori Ismaili me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes.

Përmes këtij memorandum BQK-ja synon të ndërtojë një platformë të përbashkët me Fakultetin Ekonomik, ku do të mund të zhvillohen projekte dhe iniciativa të përbashkëta për të ngritur dhe avancuar njohuritë edukative ekonomike dhe financiare në Kosovë me qëllim të përmirësimit të njohurive për çështjet ekonomike dhe

financiare për të rinjtë.

Shkëmbimi i publikimeve dhe të dhënave, ligjëratat për studentët, angazhimi i ekspertëve, bashkëpunimi hulumtues, mundësia e praktikës për studentët, shqyrtimi i kurrikulës dhe organizimi i ligjëratave me ekspertët e BQK-së, janë disa nga aktivitetet e zotuar nga BQK-ja në këtë memorandum. Marrëveshja shpreh vullnetin për të krijuar një partneritet të qëndrueshëm dhe konstruktiv

për të kontribuar në rritjen e stabilitetit ekonomik dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të Republikës së Kosovës.

Pas nënshkrimit të këtij memorandum, guvernatori Ismaili para studentëve të Fakultetit Ekonomik mbajti ligjëratën me titull "Banka Qendrore dhe roli i saj në sistemin financiar të Republikës së Kosovës" dhe në fund hapi zyrtarisht edhe thirrjen për çmimin vjetor "Ekonomist i ri".

Peci: Për tri vjet qeverisje kemi arritur ta ndryshojmë rrjedhën e sektorit të bujqësisë në Kosovë

Prishtinë, 19 mars - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka bërë me dije se për tri vjet qeverisje kanë arritur ta ndryshojnë rrjedhën e sektorit të bujqësisë në Kosovë si dhe ta fuqizojnë atë. "43,478 hektarë më shumë drithëra apo për 63% më shumë. Në kohën kur

pandemia, kriza energjetike, agresioni i Rusisë në Ukrainë dhe inflacioni, sfidonin edhe shtetet më të zhvilluara ekonomike, kemi arritur që të kemi rekord për sipërfaqet e të mbjellave. 100 mijë hektarë me drithëra. 66 mijë hektarë të mbjella me grurë,

ndërsa 42 mijë hektarë me misër. 35.5 hektarë rritje e sipërfaqeve të ngritura për prodhimtarinë e perimeve në sera. 142.22 hektarë sipërfaqja totale e ngritur me fruta manore, arrore dhe drufrutore", ka njoftuar ministri Peci.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (6)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-11-

Konfidenciale

EESD

Për djepi: Z. Bullard
16 prill 1981

Kërkesa e ambasadorit jugosllav: Kosova

1. Ambasadori jugosllav kërkoi dje pasdite për të vazhduar një diskutim të mëparshëm që ai kishte pasur me z. Bullard mbi trazirat në Kosovë kur z. Bullard i kishte sugjeruar, duke pasur parasysh vizitën e z. Eagleberger në Londër, se do të ishte e dobishme që të merreshin përshtypjet aktuale të ambasadorit mbi këto trazira.

2. Z. Berisavljeviç tha se gjatë ditëve të fundit ai ishte kujdesur për kryetarin e Parlamentit të Vojvodinës, i cili ishte larguar nga Jugosllavia të enjten e kaluar dhe ishte aktualisht në Londër për trajtim mjekësor. Për shkak të sëmundjes së z. Djoronski, kryetari i Parlamentit Federativ, atij i ishte dashur të qëndronte aty gjatë diskutimeve të qeverisë federale mbi masat e nevojshme që duhen marrë për të kontrolluar trazirat. Për këtë arsye, ai ishte plotësisht i informuar, megjithëse jo tërësisht i azhurnuar.

3. Z. Berisavljeviç tha, nëse - siç e konfirmova - nëse do të kishim lexuar deklaratën e z. Dolanc dhe të kishim raportet nga Ambasada në Beograd, ndoshta do të ishim informuar po ashtu si ai mbi ngjarjet faktike. Ai parashikonte se do të kishte tensione serioze themelore në Kosovë që lindnin nga ndryshimi i ekuilibrit të shqiptarëve dhe serbëve, varfëria e përgjithshme e krahinës me gjithë zhvillimin e konsiderueshëm ekonomik në dekadën e fundit dhe po përkeqësohej në Jugosllavi në tërësi. Përveç kësaj, kishte tensione të veçanta shoqërore mbi ekzistencën në Jugosllavi dhe në Kosovë të diferencimeve në pagë në raportin 1:5, ndërkohë që diferencimi maksimal ishte vetëm 1:2. Sidoqoftë, me gjithë këto forcime trazirat nuk do të kishin ndodhur po të mos kishte një organizim të qëllimshëm dhe të planifikuar nga ana e një grupi të vogël aktivistësh. Këta ishin drejtuar kundër Jugosllavisë që kur ishte bërë thirrja për autonominë e

-12-

Konfidenciale

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit, 22 prill 1981
I nderuar Charles,

Kosova

1. Një prej ngjarjeve në Kosovë që mund të shpjegohet në mënyrë të kënaqshme është zjarri i vënë në Patriarkanën Ortodokse Serbe në Pejë, më 16 mars. Gazeta ortodokse serbe "Pravoslavljë" ka shtuar dyshimet e versionit zyrtar mbi shkakun e zjarrit.

2. Sipas njoftimit zyrtar të dhënë të nesërmen, zjarri ishte shkaktuar nga një defekt në instalimet elektrike si dhe nga oxhaqet dhe tubat e ndërtaura në mënyrë të parregullt në një furrë me lëndë djegëse. Zjarri filloi në 3.30 të mëngjesit në pjesën e majtë fundore të ndërtesës së vjetër për të ftuarit mbi dhomat e patriarkut. Njëra prej murgeshave i ra alarmit dhe thirri skuadrën zjarrfikëse, por makina e parë zjarrfikëse mbërriti me cisternë uji të boshatisur dhe makina e dytë zjarrfikëse u prish rrugës! Murgësia vuri re më pas se papritur shpërtheu një zjarr i dytë më i fuqishëm se i pari rreth 40 metra larg catisë së ndërtesës. Ajo pohoi se zjarri nuk ishte përhapur nga vendi i parë. Skuadra zjarrfikëse filloi të shuante zjarrin në 4.30 të mëngjesit, por makinat e tjera zjarrfikëse arritën vetëm në intervalin kohor midis gjysmë ore dhe 2 orë më vonë dhe një cisternë e fuqishme me tub të gjerë arriti vetëm në orën 7.30 të mëngjesit, kur zjarri ishte përhapur në ndërtesën e re të miqve dhe deri tek Thesari. Klirikë të ndryshëm që qëndronin në kjo Patriarkanë, murgeshat dhe një numër punëtorësh arritën në shpëtonin një koleksion të paçmueshëm librash dhe objektësh të tjera fetare nga Thesari. Zjarri u shua përfundimisht pa shkaktuar dëme të kishës apo ndërtesave të tjera.

3. Shpejt u përhapën fjalë nëpër Beograd për zjarr vënie të qëllimshme që dilnin kryesisht nga Patriarkana, këtu duke u bazuar pa dyshim në ngjarjen e murgeshës më lart. Dyshimet u përqëndruan në shpërthimin e zjarrit në dy vende që nuk kishin lidhje me njëri-tjetrin dhe në mosreagimin e brigadës zjarrfikëse në mënyrë të menjëhershme dhe të efektshme. Ndeshmëria zyrtare u tregua nga vizita e menjëhershme në këtë Patriarkanë në orën 10.00 të mëngjesit po në ditën e zjarrit nga Xhavit Nimani, kryetar i Kryesisë së Kosovës, Bahrija Oruçija, kryeministër dhe Mihailo Zvicer, kryetar i Lidhjes Socialiste të Kosovës dhe të tjerë. Nimani urdhëroi ngritjen e komisionit ekspert për të shqyrtuar rindërtimin e shpejtë të ndërtesave të shkatërruara dhe të dëmtuara. Menjëherë u vunë në dispozicion para dhe materiale ndërtimi për të

bërë të mundur që të bëhej e banueshme ndërtesa e re e ndërtuar pjesërisht për miqtë. Po shihej mundësia për të bërë çdo gjë të mundshme, por në mes serbëve mbetet dyshimi.

4. Dolanc, në konferencën e tij për shtyp, më 6 prill, mohoi mesa kishte të dhëna që të kishte ndonjë lidhje ndërmjet zjarrit të vënë dhe demonstratave nacionaliste. Megjithatë, ai shtoi se hetimi për këtë çështje ishte ende në proces dhe nëse do të zbulohesh ndonjë lidhje në këtë drejtim, për rjedhojë informacioni do të bëhej i ditur. Gjerë tani nuk është thënë asgjë tjetër në këtë drejtim. Sidoqoftë, ne dimë nga rrëfimet publike të demonstratave në Kosovë se ka pasur një paragjykim serb në këtë pikë dhe nëse organizatorët do të dëshironin të bënin një gjest mbresëlënës antiserb, çfarë do të shërbente mirë se djegia e Patriarkanës serbe? Gjithsesi, askush nuk e ka marrë përsipër përgjegjësinë. Gjithashtu, komuniteti shqiptar mysliman i cili tradicionalisht e ka ruajtur Patriarkanën për breza të tërë, natyrisht u shqetësua shumë nga e gjithë kjo ndodhi.

5. Meqenëse kjo është një çështje kaq e ndezur (kërkoni ndjesë për këtë lojë fjalësh), dyshoj se cilido që të jetë shkak i zjarrit, nuk do të thuhet më asgjë për të. Por serbët do ta mbajnë mend këtë.

I Juaj,
T. J. Clark

-13-

Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit

23 prill 1981
Londër, SW1A 2AH
Peter Blaker
I nderuar Tames,

Ju falënderoj për letrën tuaj të datës 10 prill për Peter Carrington mbi përndjekjen fetare në Shqipëri. Nuk kemi një konfirmim të pavarur për vdekjen e Peshkop Çobës megjithëse dimë që ai është internuar në një fermë kolektive në vitin 1975. Por, nuk ka dyshim se në përpjekjet e tyre për të krijuar shoqërinë e parë të vërtetë ateiste në botë, autoritetet shqiptare kanë praktikuar përndjekje në shkallë të gjerë dhe brutale ndaj të krishterëve dhe myslimanëve dhe se ka pasur disa të vdekur në këtë drejtim. Natyrisht, dënojmë pa rezervë një përndjekje të tillë.

Ju i referoheni dëshirës tonë aktuale për të rivendosur marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë. Ndërkohë që jemi në djepi të natyrës shtypëse të regjimit shqiptar, do të dëshironim ta shihnim këtë si një argument kundër rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Ne kemi marrëdhënie me shumë vende, politikën e brendshme të të cilave i kundërshtojmë fuqimisht. Në të vërtetë, sipas mendimit tonë rivendosja e marrëdhënieve diplomatike mund të ndihmojë vetëm për të komunikuar drejtpërdrejt me regjimin shqiptar dhe për të bërë kështu të qartë

shqetësimin tonë të thellë për akuzat e përndjekjeve të llojit për të cilin keni tërhequr vëmendjen. Po ju kthej shkresën e BBC të datës 2 prill.

I Juaj,
Tebi Bleku

J. Dempsey Esq MP
Dhoma e Komuneve
Londër, SW1A OAA

-14-

Konfidenciale

Ambasada britanike
Beograd
24 prill 1981
Përmbledhje

Kosova



1. Vlerësim i mëtejshëm i trazirave më të fundit në Kosovë (paragrafi 1).

Ngjarjet
2. Demonstratat e studentëve filluan në Prishtinë, më 11 mars, si një protestë kundër kushteve të jetesës dhe punës. Ato rifilluan, më 26 mars, por morën ngjyra politike dhe u shtypën me ashpërsi nga forcat e milicisë. Më 1 prill, shpërthyen demonstrata të dhunshme nacionaliste shqiptare nga nxënësit e shkollave dhe studentët të cilat zgjatën për disa ditë duke lënë nëntë persona të vdekur dhe 206 të plagosur (paragrafët 2-6).

Shkaqet
3. Demonstratat u frymëzuan nga nacionalistët shqiptarë dhe pasuan me një sërë përpjekjesh të dhunshme që nga lufta e kosovarëve për të arritur një identitet kombëtar më vete nga Serbia. Nuk ka të dhëna për përfshirje sovjetike apo shqiptare, me gjithë tundimet për këtë të fundit. Ankesat ekonomike dhe shoqërore gjithashtu kanë luajtur rolin e tyre. Udhëheqja nuk arriti të lexonte dhe t'i përgjigjej siç duhet shenjave paralajmëruese (paragrafët 7-11).

Pasojat
4. Mund të ketë ndryshime në udhëheqjen e Kosovës siç analiza nxjerr në pah dobësitë në trajtimin e ngjarjeve. Partia përballat me dilemën e hershme për të pajtuar pretendimin objektivist të arsyeshëm të Kosovës për statusin e Republikës me kundërshtimet e brendshme politike dhe të sigurisë të perceptuara si parësore. Marrëdhëniet me Shqipërinë u përkeqësuan, por Jugosllavia nuk dëshiron të reagoonte më shumë. Menjëherë pas marrjes së masave përmirësuese, autoritetet janë duke u përqëndruar tashmë në masat afatgjata politike dhe ekonomike të zhvillimit (paragrafët 12-17).

Përmbledhje
5. Nacionalizmi në Kosovë është një problem endemik të cilin as Tito nuk mundi ta zgjidhte. Pas goditjes së parë, udhëheqësit aktualë treguan pjekuri në trajtimin e këtij problemi. Jugosllavia ka të ngjarë që të rrisë shqetësimin për integritetin e saj territorial. Mbështetja jonë do të mirëpritet (paragrafët 18-19). (Vijon)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Presidentja Osmani takohet me Parsons, merr ftesë për ceremoninë hapëse të Lojërave Paralimpike

PRISHTINË, 19 MARS - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur sot në takim presidentin e Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar, Andrew Parsons, të shoqëruar nga presidentja e Komitetit Paralimpik të Kosovës,

Njomza Emini. Kosova do të përfaqësohet për herë të parë në Lojërat Paralimpike "Paris 2024", ndaj presidentja Osmani e ka cilësuar këtë moment historik, duke shprehur në përfaqësim të denjë të sportistëve tanë në këto

gara ndërkombëtare. "Presidentja Osmani ka falënderuar për mbështetjen e deritashme presidentin Parsons dhe ka shtuar nevojën e vazhimit të bashkëpunimit në funksion të krijimit të kushteve sa më të mira

për parasportistët", thuhet në njoftimin e presidencës së Kosovës. Kurse presidenti Parsons e ka ftuar zyrtarisht presidenten Osmani të jetë e pranishme në ceremoninë hapëse të Lojërave Paralimpike "Paris 2024" më 28 gusht.



Kosova zhvillon stërvitjen e dytë, synohet përgatitja e mirë për ndeshjet e shtatorit

Futbollistët "dardanë", pas stërvitjes së dytë, janë deklaruar se ndeshjet miqësore ndaj Armenisë dhe Hungarisë do të shërbejnë për ta kuptuar filozofinë e trajnerit të ri, Franco Foda, por edhe për t'u përgatitur sa më mirë për ndeshjet në Ligën e Kombeve që fillojnë në shtator

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 MARS - Futbollistët e Përfaqësueses së Kosovës në futboll të martën e kanë zhvilluar stërvitjen e dytë para ndeshjeve miqësore që i zhvillojnë në këtë muaj.

"Dardanët" në Kampin Nacional në Hajvali, në drejtimin e përzgjedhësit Franco Foda, kanë stërvitur me përkushtim në aspektin tekniko-taktik për t'u

përgatitur sa më mirë për miqësoret ndaj Armenisë më 22 mars dhe Hungarisë më 26 mars.

Në seancën e dytë stërvitore përzgjedhësi Foda është përqendruar në thellimin e aspektit taktik, duke sqaruar idetë dhe filozofinë e lojës që synon të ndërtojë me ekipin dardan. Pas stërvitjeve kanë folur futbollistët Mërgim Vojvoda, Valon Berisha dhe portieri Ilir Avdyli.

Për mbrojtësin e Torinos, Mërgim Vojvoda, këto dy miqësore



shërbejnë të përgatiten sa më mirë për ndeshjet e muajit shtator. "Këto dy miqësore i kemi që të përgatitemi mirë në ambientin e ri, me motivim të ri dhe për synime të reja. Duhet të kuptohemi me idenë dhe filozofinë e trajnerit. Këto miqësore do të na shërbejnë të përgatitemi për ndeshjet e

shtatorit", ka thënë Vojvoda.

Ndërsa Valon Berisha, i cili është një nga lojtarët më me përvojë në radhët e "dardanëve", pas stërvitjes, ka deklaruar se këto miqësore do të shfrytëzohen sa më shumë ta kuptojnë filozofinë e trajnerit Foda, por edhe të bëhen sa më të fortë për ndeshjet në Ligën e Kombeve. "Këto dy ndeshje do t'i shfrytëzojmë për ta kuptuar trajnerin dhe filozofinë e tij, ta krijojmë grupin dhe të bëhemi sa më të fortë për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Sot kemi punuar më shumë taktikisht, ndërsa nesër do të punojmë më shumë për fazën defensive. Duhet të adaptohemi sa më shpejt. Janë dy ndeshje miqësore, por të rëndësishme dhe duhet t'i fitojmë sepse na ndihmojnë për atmosferën në ekip",

ka deklaruar Berisha.

Përzgjedhësi Franco Foda, përveç Aro Muriqit dhe Visar Bekajt, e ka ftuar edhe portierin Ilir Avdyli, i cili rikthehet në përfaqësues pas shtatë vjetësh. Mirëpo në atë kohë futbollit i Kosovës nuk ishte pranuar. Avdyli ka thënë se është privilegj që është ftuar në Përfaqësuesen e Kosovës. "Privilegj i madh të jem pjesë e Kombëtares së Kosovës. Kam qenë pjesë e grumbullimit edhe para shtatë vitesh kur nuk ishim të pranuar, por sot është krejtësisht ndryshe, ka konkurrencë të fortë dhe është ndjenjë tejet e veçantë", ka thënë Avdyli. Stërvitjen e radhës "Dardanët" e zhvillojnë sot (e mërkurë) në orën 10:45 në Hajvali, më pas në orët e pasdites udhëtojnë për në Yerevan.

Parsons: Jam krenar që flamuri i Kosovës do të valoj në Lojërat Paralimpike 'Paris 2024'

"Epoka e re"

PRISHTINË, 19 MARS - Komiteti Paralimpik i Kosovës ka mbajtur të martën konferencë për medie, në përfundim të vizitës së presidentit të Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar në Kosovë, Andrew Parsons.

Presidentja e KPK-së, Njomza Emini, u shpreh e lumtur për vizitën e Parsons në Kosovë, teksa theksoi se kjo vizitë e realizuar pak muaj pas anëtarësimit në këtë komitet, është dëshmi shtesë e mbështetjes që Kosova po pranon në arenën ndërkombëtare. "Vizita e Parsons në Kosovë është sinjal i qartë i

mbështetjes, reflektim për punën dhe përkushtimin e komitetit tonë, por edhe mesazh për këdo në botë që ne jemi të barabartë dhe meritojmë trajtim të tillë", ka thënë Emini, e cila ka shtuar që njëtrajtësisht me rritjen e privilegjit, është rritur edhe përgjegjësia e KPK-së, përderisa sivjet Kosova do ta shënojë debutimin në garën më të madhe ndërkombëtare të para sportit, Lojërat Paralimpike Botërore "Paris 2024".

Në anën tjetër, presidenti Parsons falënderoi presidenten Emini për mikpritjen e ngrohtë. Ai vlerësoi lart takimet me nivele të ndryshme të



qeverisjes dhe tha se nga kjo vizitë triditore ka kuptuar shumë për sfidat me të cilat përballet Komiteti Paralimpik në Kosovë. "Unë jam krenar, e ashtu duhet të jeni edhe ju, përderisa për herë të parë do ta shihni edhe flamurin tuaj në

ceremoninë hapëse të Lojërave Paralimpike Botërore më 28 korrik në Paris. Është nder edhe për ne ta shohim flamurin tuaj duke u valitur", ka thënë Parsons. Ai theksoi se vizioni i parasportit në Kosovë nuk është vetëm paralimpizmi, por përdorja e sportit për krijimin e një bote gjithëpërfshirëse.

Në këtë konferencë rreth parasportit dhe vizitës së Parsons në Kosovë folën edhe nënkryetari i Komitetit Paralimpik, Daut Tishukaj dhe Anton Nrecaj, kryetar i Federatës së Paranotit. Gjatë vizitës tri ditore, në koordinim me

Komitetin Paralimpik të Kosovës, presidenti i Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar ka zhvilluar takime me kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurtin, kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufcën dhe ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çekun, si dhe me paraatletë e partnerë të parasportit.

Komiteti Paralimpik i Kosovës rreth gjashtë muaj më parë është anëtarësuar në Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar. Sivjet parasportistët kosovarë do të debutojnë në lojërat ndërkombëtare duke marrë pjesë në Lojërat Paralimpike Botërore që do të zhvillohen në Paris.

Presidenti Ademi priti në takim zyrtarët e S. L. Benfica

PRISHTINË, 19 MARS - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur sot në takim përfaqësuesit e klubit portugez S. L. Benfica, Miguel Reis, koordinator për zgjerim global si dhe zyrtarin e lartë teknik, Davide Gomes. Temë diskutimi në takim ishte futbollit i Kosovës, mundësia e bashkëpunimit me klubet dhe identifikimi i talenteve të rinj, e që për fat Kosova ndonëse vend

i vogël, ka ndërtuar futbollistë të suksesshëm të cilët luajnë në ligat më të mëdha në Evropë. Zyrtarët e S. L. Benfica shprehën mirënjohje për punën që po bëhet në zhvillimin e futbollit këtu, derisa të njëjtët shfaqën interesimin për t'i parë nga afër të rinjtë e Kosovës të cilët e kanë pasion futbollin. "Gjatë takimit u diskutua edhe për mundësinë e bashkëpunimit

bilateral në shumë fusha. Përveç misionit për të identifikuar talente dhe atyre pastaj t'u krijohen mundësi të reja në zhvillimin dhe avancimin e tyre, theks të veçantë në këtë takim pati edhe tema për fushën e edukimit, siç është organizimi i seminareve për trajnerë, por edhe aspekte të tjera bashkëpunimi në projekte edhe më madhore", thuhet në njoftimin e Federatës



së Futbollit të Kosovës. Në fund të takimit, presidenti Ademi ndau rekuizita për mysafirët,

ndërsa të njëjtët shprehën falënderimin e tyre për mikpritjen e ngrohtë.

Nuza delegohet nga UEFA për ndeshjen kualifikuese U21: Belgjika - Malta

PRISHTINË, 19 MARS - Gjyqtari i njohur për integritetin dhe drejtësinë e tij në fushën e gjelbër, Genc Nuza, është deleguar nga UEFA për ta drejtuar ndeshjen kualifikuese U21 për "Euro 2025" midis

Belgjikës dhe Maltës, e cila zhvillohet më 21 mars. Ky delegim vë në dukje besimin në rritje të UEFA-s në aftësitë dhe profesionalizmin e gjyqtarëve të Kosovës. Në këtë ndeshje Nuza do të ketë për

asistentë dy gjyqtarë të tjerë të spikatur, Edmond Zeqiri dhe Granit Hyseni, derisa Mentor Ajeti do të jetë gjyqtar i katërt. Kësisoj, me një përvojë të gjatë në ndarjen e drejtësisë dhe me një përkushtim të

vazhdueshëm për t'i ngritur standardet, Nuza dhe bashkëpunëtorët e tij do ta përfaqësojnë futbollin e Kosovës në një tjetër paraqitje të rëndësishme ndërkombëtare.



Dy ndeshje zhvillohen sot dhe dy nesër në elitën e basketbollit

PRIZREN, 19 MARS - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e 26-të në Prince Caffè Superligë. Në Prizren do të ndeshen dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës, Bashkimi dhe Sigal Prishtina. Prizrenasit ndodhen në vendin e gjashtë me dhjetë fitore dhe 15 humbje, kurse prishtinasit në vendin e katërt me 15 fitore dhe dhjetë humbje. Të dyja skuadrat kërkojnë një vend sa më lart në renditje, që është shumë e rëndësishme për "play-off". Dy skuadrat që kanë siguruar "play-off"-in, Golden Eagle Ylli dhe Vëllaznimi, ndeshen në Therandë.



Ylli është në vendin e tretë me 16 fitore e nëntë humbje, kurse kuqezinjtë janë në vendin e pestë me 11 fitore e 14 humbje. Të enjten Istogu do të ndeshet me kampionen, Pejën. Istogasi kanë një fitore e 24 humbje, kurse verdhezinjtë janë në pozitën e dytë

me 17 fitore e tetë humbje. Dueli i fundit i kësaj xhiroje është ndërmjet Trepçës dhe Proton Cable Prizrenit. Mitrovicasit kanë siguruar vendin e parë me 23 fitore e vetëm dy humbje, kurse prizrenasit janë në vendin e pestë me shtatë fitore e 18 humbje.

SUPERLIGA - Java 26

Të mërkurën takohen:
19:00 Bashkimi - Sigal Prishtina
19:00 Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi

Të enjten takohen:
19:00 Istogu - Peja
20:00 Trepça - Proton Cable Prizreni

Bostoni i pandalshëm, lakersat rikthehen te fitorja, zhgënjejnë Golden State dhe Miami



BOSTON, 19 MARS - Bostoni nuk ndalet në rrugëtimin e tij këtë sezon në NBA, duke fituar me rezultat 119-94 ndaj Detroitit. Triumf i lehtë për Celticsin, ku u dallua Browni me 31 pikë, ndërkohë që tre lojtarë të tjerë realizuan mbi 20 pikë. Rikthehet

te fitorja skuadra e lakersave, që mundi me rezultat 136-105 Atlantan. Të gjithë titullarët e ekipit kalifornian realizuan mbi 10 pikë, ku u dalluan Russell me 27 pikë dhe 10 asistime si dhe LeBron Jamesi me 25 pikë. Fitore të rëndësishme për zonën "play-off"

korri Philadelphia, që mundi me shifrat 98-91 Miamin, sfidë ku dallimin e bëri Maxey, autor i 30 pikëve dhe 10 asistimeve. Fitore në sekondat e fundit për Chicagon, që mundi me rezultat 110-107 Portlandin falë 28 pikëve të DeRozanit. Zhgënjeu skuadra e Golden States, që u mund me rezultat 119-112 në fushën e saj nga New Yorku. Për miqtë u dallua Brunsoni me 34 pikë. Minnesota u bashkohet ekipeve të kreut në Perëndim pas fitores me shifrat 114-104 ndaj Utah Jazzit (Edwards 32 pikë).

REZULTATET

Indiana - Cleveland	103-108
Boston - Detroit	119-94
Philadelphia - Miami	98-91
Chicago - Portland	110-107
Utah Jazz - Minnesota	104-114
Golden State - New York	112-119
Sacramento - Memphis	121-111
Lakers - Atlanta	136-105

SHKURT

Katër ekipe arabe synojnë Raphinhan, Barcelona kërkon 70 milionë euro

Për brazilianin Raphinha, Barcelona ka marrë një ofertë të re nga Arabia Saudite, por ende nuk është përgjigjur, raporton "Sport". 27-vjeçari u largua nga Leeds United verën e vitit 2022 për 57 milionë euro dhe nënshkroi një kontratë pesëvjeçare me Barcelonën deri në vitin 2027. Ai është në sezonin e tij të dytë në "Camp Nou" (78 ndeshje e 15 gola në takimet zyrtare) dhe paguhet rreth 5.5 milionë euro në sezon. Anëtori me tipare sulmuese nuk e ka fshehur dëshirën për të qëndruar, por janë katër skuadra arabe që kërkojnë shërbimet e tij: Al-Hilal (ekipi që vendosi rekordin me 28 fitore radhazi), Al Nassri (luan Cristiano Ronaldo), Al-Ittihad (luan Benzema) dhe Al-Ahli. Gjithsesi, Barcelona nuk do të heqë kollaj dorë nga lojtari, ndaj katalanasit kërkojnë rreth 70 milionë euro nga largimi i parakohshëm i Raphinhas.

'Epoka' e Neuerit drejt fundit, Bayerni interesohet për portierin e Milanit

Prej kohësh në mediet italiane dhe në ato gjermane po qarkullojnë gjithnjë e më shumë lajmë që lidhin interesimin e "bavarezëve" të Bayern Munchenit me një prej protagonistëve absolut të 19 herë kampionëve të Italisë. Në "radarët" e "bavarezëve" ka rënë një prej "yjeve" francez të "Djajve" të Milanos, me kampionët e Bundesligës që prej kohësh janë në kërkim të një "gardiani" të ri për portën dhe këtu hyn në skenë Mike Maignan. Francezi ka bërë paraqitje të shkëlqyera me "kuqezinjtë" e Milanos dhe kjo ka tërhequr vëmendjen e gjigantëve të Munchenit, të cilët po kërkojnë një pasues të denjë për "legjendën" e portës, Manuel Neuer.

Granada shkarkon trajnerin Medina

Me skuadrën që nuk fiton prej datës tre janar dhe të renditur në vendin e parafundit të La Ligas me vetëm 14 pikë pas 28 javësh, drejtuesit e Granadës janë detyruar ta ndryshojnë sërish trajnerin. Njëpërmjet një njoftimi në kanalet zyrtare, klubi spanjoll ku aktivizohet edhe futbollisti i kombëtares, Myrto Uzuni, njoftoi mbylljen e bashkëpunimit me Alexander Medina. Medina është trajneri i dytë që shkarkohet nga Granada pas Paco Lopez me të cilin nisi sezonin. 45-vjeçari mori drejtimin e skuadrës në fundin e muajit nëntor të vitit të kaluar, por në 14 ndeshje uruguaiani koleksionoi vetëm një fitore dhe katër barazime. Pritet që Granada të emërojë në postin e trajnerit Jose Ramon Sandoval. Bëhet fjalë për një rikthim pasi 55-vjeçari e ka drejtuar Granadën në sezonin 2015-2016, ndërsa së fundmi Sandoval ishte në krye të Fuenlabradas.

Franca pa Griezmannin në miqësoret e marsit

Kombëtarja e Francës do të duhet t'i bëjë llogaritë pa Antoine Griezmann në dy miqësoret e këtij muaji. Griezmanni ka pësuar një lëndim në kyçin e këmbës dhe, sipas RMC Sport, nuk do të jetë i gatshëm për Deshamps. Mungesa e sulmuesit të Atleticos do të thotë se pas 84 ndeshjesh kombëtarja franceze do të luajë pa të. Hera e fundit që Griezmanni humbi një ndeshje me Francën ishte në qershor 2017, kur ai nuk u aktivizua, edhe pse ishte në stol, në fitoren 3-2 të ekipit të tij ndaj Anglisë. Trajneri i Francës, Deschamps, ka grumbulluar Guendouzin e Lazios pas largimit nga grumbullimi të Greizmannit. Francën e presin dy miqësore gjatë këtij muaji, me kombëtare si Gjermania dhe Kili.

Pique: Xavi do të qëndroj te Barcelona

E ardhmja e Xavit vazhdon të jetë e paqartë nëse do të jetë te Barcelona apo do të largohet në fund të sezonit. Trajneri katalunas muaj më parë ka konfirmuar se në fund

të sezonit do të largohet, por shumë zëra kanë qarkulluar se ai do të mbetet. Edhe presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, ka deklaruar se ata do të

ishin të lumtur nëse Xavi do të mbetet në klub së paku edhe sezonin e ardhshëm. Për këtë ka folur tani edhe legjenda e Barcelonës, Gerard Pique, i cili ka

thënë se është i bindur se Xavi do të mbetet në klub edhe për sezonin e ri. "Nuk mendoj se vendimi i Xavit është 100 për qind... të shohim, mendoj se do të qëndrojë dhe jam

i sigurt. Unë nuk flas çdo ditë me Xavin, por kemi folur disa herë. Unë dua më të mirën për të, sepse jam i sigurt se do të jetë më e mira për klubin", ka thënë Pique.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "DoniFert" Sh.p.k. – Baicë, Drenas në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Zgjerimin e sipërfaqës eksploatuese të gurit gëlqeror në Baicë, Komuna Drenas.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.05.2024 në ora 10:00 në SHFMU "MIGJENI" Fshati Baicë komuna e Drenasit, do të organizohet debat publik nga Kompania "DoniFert" Sh.p.k. – Baicë, Drenas në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "DoniFert" Sh.p.k. – Baicë, Drenas për Zgjerimin e sipërfaqës eksploatuese të gurit gëlqeror në Baicë, Komuna Drenas

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë operatorët ekonomik se Kompania "FRESH CLEAN PRO Sh.p.k. Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër unik identifikues: 811992777 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë operatorët ekonomik që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë

ANNOUNCEMENT

All economic operators are to be informed that the company FRESH CLEAN PRO L.L.C in Prizren has come to the decision to quit its business with Unique identification number: 811992777

The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process.

All economic operators who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of the newspaper announcement publication.

OBAVESTENJE

Obavestvaju se svi ekonomski operater da poduzeca "Fresh Clean Pro Doo, u Prizren donelo odluku o prestani rada sa Jedinstveni matični broj: 811992777 I ujedno imenovao likfidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obevestavaju se svi ekonomski operater koji imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jahja Hoti shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Fati Ademaj shpall te pavlefshme dëftesat shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Arbër Mustafaj nga Petkoviqi KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Zize Agaj nga Gramaqeli KK Deçan shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Manë Isafi nga Beci KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

